



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.20

19 mars

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim plotësues i MF nr. 2/1, datë 15.2.2012	Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012.....	803
Urdhër i METE nr. 83, datë 10.2.2012	Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure	826

UDHËZIM PLOTËSUES
Nr. 2/1, datë 15.2.2012

PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2012

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 19 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2, Ministri i Financave

UDHËZON:

I. PROCEDURA SPECIFIKE SHITESË PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHITETIT

Detajimi i disa fondeve buxhetore

1. Fondi i planifikuar sipas klasifikimit ekonomik buxhetor art. 604 për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, Ministria e Shëndetësisë paraqet te nëpunësi i parë autorizues, struktura përgjegjëse për buxhetin, detajimin sipas strukturave buxhetore të miratuara. Fondet për spitalet bëhen të disponueshme në kapitullin 08 (burimi i fondit buxhetor).

2. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, janë planifikuar fondet për investime për arsimin universitar edhe në formën e fondeve për zhvillimin e rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë do të përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes së projekteve pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, të cilat miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë mund të bashkëfinancojnë për objekte investimesh edhe nga të ardhurat e veta.

3. Investimet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën vendore çelen në strukturën ministria e linjës 00, program xxxxx, kapitull 05, të specifikuar me kode projekti. Shkresat e çeljes së këtyre fondeve do të hidhen në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtën e ndryshimit të emërimit të projekteve.

4. Fondet për projekte të reja të investimeve dhe blerjen e pajisjeve elektronike, të cilat nuk e kanë ndjekur ciklin e planifikimit të investimeve publike, dhe që lidhen me teknologjinë e informacionit, bëhen efektive pas konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Numri i punonjësve buxhetorë dhe shpenzimet e personelit

5. Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 10 355, datë 2.12.2011, për vitin 2012, nuk do të miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njërive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit. Efektet financiare shtesë përlllogariten nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe miratohen nga Ministri i Financave. Përrjashtim bëjnë këtu institucionet e reja të krijuara me ligj.

6. Numri rezervë i punonjësve përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit dhe alokohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedurat e detajimit dhe të miratimit përcaktohen në të njëjtën mënyrë si për punonjësit organikë.

7. Si punonjës me kontratë të përkohshme pune, krahas atyre të miratuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, konsiderohen edhe instruktorët e qendrave të formimit profesional të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe anketuesit e Institutit të Statistikave. Autorizimi i pagesave për këta punonjës realizohet vetëm me udhëzim të përbashkët midis Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Institutit të Statistikës për të dyja kategoritë e punonjësve.

8. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore përdoret nga çdo njësi shpenzuese për numrin faktik mujor të punonjësve në organikë, brenda numrit limit të miratuar. Nuk lejohet përdorimi i fondit të lirë që rezulton nga strukturat e paplotësuara dhe vetëm në raste specifike, përdorimi i këtij fondi miratohet nga Ministria e Financave. Fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore përdoret për pagesën e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, kur është parashikuar një fond i tillë nga Ministria e Financave.



9. Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahen në konsideratë rregullat e përcaktuara në shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

10. Plotësimi i borderosë së pagave të bëhet sipas shtojcës nr. 4 të këtij udhëzimi.

Fondi i veçantë

11. Fondi i veçantë i njërive shpenzuese nuk është pjesë e fondit të pagave, pasi ky fond do të alokohet dhe përdoret me miratim të Ministrit të Financave. Limiti maksimal i fondit të veçantë i parashikuar për t'u përdorur për çdo njësi të qeverisjes qendrore dërgohet nga Ministria e Financave. Njësitë e qeverisjes qendrore njoftojnë të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë për limitin maksimal të fondit të veçantë për t'u shpenzuar prej tyre. Përdorimi i fondit të veçantë bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë".

12. Kërkesat për përdorimin e fondit të veçantë brenda limitit të njoftuar do të paraqiten rast pas rasti nga njësitë e qeverisjes qendrore te nëpunësi i parë autorizues, i cili i shqyrton nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin dhe propozon për miratim te Ministri i Financave. Kjo kërkesë duhet të përmbajë edhe informacionin lidhur me shumën e përdorur nga fondi i veçantë deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë.

Pagesat në valuta të huaja

13. Gjatë procesit të menaxhimit të shpenzimeve të projekteve me financim të huaj, që administrohen me skemë të pjesshme thesari, transfertat nga llogaritë speciale në Bankën e Shqipërisë në llogaritë bankare të projekteve me financim të huaj, kryhen në monedhën shqiptare nga struktura qendrore përgjegjëse për thesarin, përveç kontratave të lidhura në valutë të huaj sipas paragrafit 145 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012.

Të ardhurat jashtë limitit

14. Në të ardhurat jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e procedurave standarde të zbatimit të buxhetit, përfshihen edhe të hyrat e mëposhtme:

- a) Të hyrat që mblidhen nga zyrat e përmbartimit për llogari të të tretëve;
- b) Të ardhurat që institucionet sportive arkëtojnë nga pjesa që u takon me ligj nga llotosporti ose nga sponsorizimet e tjera;
- c) Fondet e akorduara nga Kompania Energjetike Shqiptare për përballimin e dëmeve nga përmbytjet¹;
- d) Të ardhurat nga organizmat e vlerësimit të konformitetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, përdoren për pagesën e vlerësuesve të kontraktuar nga kjo drejtori në zbatim të ligjit nr. 9824, datë 1.11.2007 "Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1716, datë 3.10.2008 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit" dhe standardit S SH ISO 17011:2005, që rregullon veprimtarinë e organizmave akreditues;
- e) Të ardhurat e realizuara nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje "Për transferimin e parcelës ndërtimore", sipas aktrakordimit midis zyrës qendrore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritit të Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe strukturave përgjegjëse për thesarin në degë, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë speciale të fondit të kompensimit të pronave, pranë Bankës së Shqipërisë;
- f) Të ardhurat nga Parku Kombëtar i Butrintit;
- g) Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane dhe strukturës përgjegjëse për doganat shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë.

¹ Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1014, datë 15.12.2010 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 989, datë 9.12.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit të emergjencave civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmbytjet natyrore".

15. Në të ardhurat jashtë limitit që nuk mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e procedurave standarde të zbatimit të buxhetit, përfshihen edhe të ardhurat e mëposhtme:

a) Të ardhura nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor;

b) Të ardhurat nga shtëpitë e pushimit të Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shqiptar, si dhe të ardhurat nga shërbimi i karroatrecit.

II. KRITERE DHE PROCEDURA SPECIFIKE SHITESË PËR ZBATIMIN E BUXHETIT VENDOR

16. Transferta e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore çelet e ndarë në tremujorë, si vijon:

a) Për qarqet, në tremujorin e parë 35%, të dytin 30%, të tretin 20%, të katërtin 15%;

b) Për komunat, në tremujorin e parë 35%, të dytin 25%, të tretin 20%, të katërtin 20%;

c) Për bashkitë, në tremujorin e parë 30%, të dytin 20%, të tretin 20%, të katërtin 30%.

17. Për njësitë e qeverisjes vendore sipas aneksit 4 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011, në transfertën e pakushtëzuar të bashkive: Berat, Çorovodë, Peshkopi, Burrel, Durrës, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Ersekë, Leskovik, Lezhë, Rrëshen, Rubik, Kukës, Krumë, Shkodër, Pukë, Tiranë, Vlorë, Sarandë dhe të komunave, Qendër Fier, Golem Kavajë, Kelmend Malësi e Madhe janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të konvikteve të arsimit parauniversitar.

18. Për njësitë e qeverisjes vendore sipas aneksit 5 të ligjit, në transfertën e pakushtëzuar të bashkive: Berat, Elbasan, Kuçovë, Kukës dhe Shkodër, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të shërbimit dhe shpenzimet operative për qendrat: “Lira”, Berat; “Balash”, Elbasan, dhe qendrat ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara për bashkinë Kuçovë, Kukës dhe Shkodër. Mbi këtë bazë, çdo njësi e qeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga këshilli depozitohet në Ministrinë e Financave sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

19. Në vijim të përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (pjesa e buxhetit vendor), jepen procedura plotësuese për vitin 2012, si më poshtë vijon:

a) Për funksionet e përbashkëta. Njësitë e qeverisjes vendore përfitojnë fondet për investime për arsimin parauniversitar, nëpërmjet paraqitjes së projekteve pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të vlerësimit të tyre nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve krijuar për këtë qëllim, nëpërmjet konkurrimit sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.

b) Për funksionet e përbashkëta. Njësitë e qeverisjes vendore përfitojnë nga fondet për investime për qendrat shëndetësore dhe ambulancat e shërbimit parësor shëndetësor në Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, nëpërmjet paraqitjes së projekteve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe të vlerësimit të tyre nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve i krijuar për këtë qëllim, nëpërmjet konkurrimit në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.

c) Për funksionet e deleguara. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për vitin 2012 shpërndan në mënyrë periodike fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë, duke monitoruar dhe vlerësuar nevojat dhe nivelin e varfërisë së njësive të qeverisjes vendore.

d) Për funksionet e deleguara. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta financon bashkitë për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të përkujdesit shoqëror të transferuara në njësitë e qeverisjes vendore që u shërbejnë individëve, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore.

20. Fondet për zhvillimin e rajoneve. Fondet për zhvillimin e rajoneve do të shpërndahen në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në aneksin nr. 3 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”.



21. Të ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore. Kuota që njësitë e qeverisjes vendore, derdhen në favor të këshillit të qarkut, miratuar me vendim të këshillit të qarkut, është e detyrueshme për t'u zbatuar në bazë të nenit 54 të ligjit nr. 8652 datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Fondet e krijuara nga kuotat e anëtarësimit, nuk duhet të përdoren për paga dhe shpërblime për personelin administrativ të këshillit të qarkut. Strukturat përgjegjëse për thesarin në degë, me autorizim të këshillit të qarkut bllokojnë përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk zbatojnë vendimin e këshillit të qarkut përkatës.

22. Sipas nenit 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të zbatojnë kufijtë e përcaktuar në këtë ligj për përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, si kosto për personelin administrativ. Në shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi, janë klasifikuar njësitë e qeverisjes vendore, sipas numrit të popullsisë dhe kufirit përkatës të shpenzimeve të personelit administrativ. Në shpenzimet e personelit administrativ përshihen pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e administratës të njësisë së qeverisjes vendore (komunës/bashkisë/qarkut), jo personelit që lidhet me kryerjen e shërbimeve publike.

23. Komunat dhe bashkitë përdorin jo më pak se 10 për qind të transfertës së pakushtëzuar për mbështetjen e pemëtarisë dhe të gjelbërimit. Rregullat, procedurat dhe skema e financimit dhe e bashkëfinancimit miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

24. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, të cilat nuk i kanë përfunduar procedurat e rimbursimit të pajisjeve fiskale, të blera e të vendosura në funksionim sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 354, datë 18.11.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1065, datë 29.12.2010 "Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimet", do të rimbursohen nga fondet në dispozicion të Këshillit të Ministrave, sipas urdhrit të Ministrit të Financave nr. 1, datë 6.1.2012 "Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit të njësive të qeverisjes vendore të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimet". Fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2012, në formën e transfertës së pakushtëzuar nuk përdoren për rimbursimin e kostos së pajisjeve fiskale. Këshilli i Ministrave, nga fondet në dispozicion të tij, rimburson koston e pajisjeve fiskale, në përputhje me kërkesat e njësive të qeverisjes vendore.

25. Të ardhurat nga renta minerare përdoren sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen në udhëzimin specifik të Ministrit të Financave.

26. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të këshillit vendor, për të gjithë tatimpaguesit (ku përfshihen si tatimpaguesit familjarë, ashtu edhe bizneset), në territorin përkatës.

III. PËRCAKTIME TË FUNDIT

27. Pjesë integrale e këtij udhëzimi janë formatet e zbatimit të buxhetit, bashkëlidhur si më poshtë:

- a) Shtojca 1 "Formati i detajimit të fondeve buxhetore";
- b) Shtojca 2 "Formati i transferimit të fondeve buxhetore";
- c) Shtojca 3 "Zbatimi i fondit limit të pagave";
- d) Shtojca 4 "Borderoja e pagave të njësive të qeverisjes së përgjithshme";
- e) Shtojca 5 "Klasifikimi i njësive të qeverisjes vendore, sipas numrit të popullsisë dhe kufirit përkatës të shpenzimeve të personelit administrativ";
- f) Shtojca 6 "Raportimi i financimeve të huaja";
- g) Shtojca 7 "Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve buxhetorë";
- h) Shtojca 8 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve";
- i) Shtojca 9 "Raporti i realizimit të rezultateve të programit";
- j) Shtojca 10 "Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas rezultateve";
- k) Shtojca 11 "Raporti i projekteve me financim të brendshëm";

l) Shtojca 12 “Raportimi i fondit të pagave dhe numrit të punonjësve të njësisë së qeverisjes vendore”;

m) Shtojca 13 “Shkresa e njësive vendore për hapje llogarie bankare huamarrjeje”;

n) Shtojca 14 “Formati i raportimit të aktiveve në pronësi” sipas paragrafit 258 të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 2, datë 6.2.2012.

28. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë në 31 dhjetor 2012.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



SHTOJCA NR. 1
FORMATI I DETAJIMIT TË FONDEVE BUXHETORE 2012 PËR NJËSINË E QEVERISJES
SHEMBULL: AUTORITETI I KONKURENCËS

(Në lekë)

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi institucioni	Emër institucioni	Kapitull	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së thesarit	Debiti	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	6000000	3535	33,400,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	6010000	3535	5,600,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	6020000	3535	13,000,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	2310000	3535	2,500,000	M770006	Blerje autoveture
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	2310000	3535	1,000,000	M770003	Blerje pajisjesh kompjuterike
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	2310000	3535	500,000	M770002	Blerje pajisjesh zyre
TOTALI								56,000,000		

SHTOJCA NR.2:
FORMATI I TRANSFERIMIT TË FONDEVE BUXHETORE 2012

lekë

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi institucion	Emër institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së thesarit	Kod projekti	Emërtimi i projektit	Debiti
			Pakësohet							950,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	6000000	0202			400,000
001	06	1006075	Drejtoria Rajonale Rrugore Lezhe	01	04520	6000000	2020			150,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	2300000	0202	M061903	Studim-projektim ...	400,000
			Shtohet							
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	6010000	0202			300,000
001	06	1006060	Drejtoria Rajonale Rrugore Durrës	01	04520	6010000	0707			250,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	2310000	0202	M061860	Sistemim-asfaltim, rruga hyrëse Berat	400,000

SHTOJCA NR.3
ZBATIMI I FONDIT LIMIT TË PAGAVE

Në zbatimin e fondit limit të pagave, të mbahet në konsideratë që:

I. Referuar ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 2, në administratën publike, të drejtën për caktimin e pagës e kanë vetëm Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave.

II. Referuar ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, neni 3, paga më e lartë në institucionet e administratës publike, buxhetore dhe jobuxhetore, në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit të Republikës, e cila përcaktohet çdo vit në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit. Paga minimale mujore në shkallë vendi dhe kufiri minimal mujor për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

III. Paga e funksionarëve të lartë shtetërorë të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, i sipërcituar, përcaktohet në raport me pagën e Presidentit sipas lidhjes përkatëse të këtij ligji.

IV. Pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar, të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, i sipërcituar, si dhe pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar të të gjitha njësive të qeverisjes së përgjithshme, përcaktohen me vendimin me nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim. Në këtë vendim, vlera e pagës së diplomës është e grupuar në 3 nivele dhe çdo pozicion pune ka një emërtësë të përcaktuar që i përgjigjet detyrimit një nivel të caktuar të diplomës (pagës së grupit). Kjo nënkupton që në një funksion i cili ka në emërtesën e tij, pagën e grupit 1, nuk mund të emërohet një nëpunës i cili ka përfituar një diplomë të grupuar në nivelin 2.

V. Pagat e të gjithë punonjësve të administratës publike që klasifikohen si punonjës mbështetës, pavarësisht arsimimit individual të tyre, përcaktohen në vendimin nr. 551, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim.

VI. Pagat e punonjësve të sistemit arsimor, të sistemit shëndetësor, të sistemit me grada, si dhe të punonjësve të Aviacionit Civil dhe Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri, përcaktohen me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.



SHTOJÇA NR. 4
BORDEROJA E PAGAVE TË NJESIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Insitucioni:																									
Kodi institucionit:																									
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24		
Emri mbiemri	Emërtesa sipas strukturës së miratuar	D.pune (+ L.zakonsh.)	Kategoria (klasa)	Paga grupit	Paga për funksion	Raporte mjekësore të paguara nga punëdhënësi (6001002)	Shtesë page për vjetërsi në punë (6001003)			Shtesa page për vjetërsi dhe rreziqe (6001004)	Shtesa page për funksion (6001005)	Shtesa pagë për turne të dyta dhe të treta (6001006)	Shtesa për pagë për largësi nga qendra e banimit (6001007)	Shtesë page për kualifikim (6001008)	Shtesa për pagë për gradat ushtarake (6001009)	Shtesa për ushtarakë të liruar në reformë (600101)	Shtesa page për bashkëshortet e papunat të ushtarakeve të transferuar (6001011)	Shtesa page dhe pagë e menjëhershme për funksionarët e për funksionarët (6001012)	Shtesa page për punë jashtë orarit (6001013)	Shtesa për pagë për punonjësit që rregullohen me akte të veçanta (6001014)	Shpërblim e për rezultate në punë (60031)	Të tjera shpërblim e për personelin (60039)	Paga bruto mujore		
							Vite	%	Lekë																
25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48		
Kufiri i pagës	11.2% (Sig. shoq.)	Tatim page	Sig.suplement ar	Të tjera (telefon etj.)	Shuma ndalesa	Shuma neto	Ditë kalendarik e pa punuar gjatë muajt (e drejta për përfitime nga sig shoq.)	Ditë kalendarik e të punuara të subjekti gjatë muajt	Paga bruto në lekë		Gjithsej	Mbi të cilën llogariten kontributet	Gjithsej	Kontribute për sigurimet shoqërore në lekë		Kontribute shtesë (sigurimet suplementare)	Kontribut e për sigurimet shëndetësore gjithsej	Paga bruto mbi të cilën llogariten tatimet mbi të ardhurat nga punësimi	Tatimet mbi të ardhurat nga punësimi	Paga mujore	% Sig.suplement ar	Sig.suplement ar	Banka	Nr. i llogarisë	Vlera lekë
									Gjithsej	Mbi të cilën llogariten kontributet				Nga këto:											
<p>Formati i bordrosë është ndarë në dy pjesë, nga të cilat:</p> <p>i) Për kolonat nga 1-24 janë futur të gjitha elementet përbërëse të pagës me të gjitha shtesat përkatëse të saj;</p> <p>Për ato institucione të cilat sipas vendimit të Këshillit të Ministrave përkatës të pagave nuk i zbatojnë të gjitha shtesat e paraqitura në këtë format, mund t'i heqin disa prej këtyre kolonave gjatë përdorimit;</p> <p>ii) Në kolonat nga 25-48 janë paraqitur të gjitha ndalesat përkatëse;</p> <p>Autorizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore kryhet mbi bazën e listës së pagës mujore (borderosë) të plotësuar detyrimisht sipas formatit të paraqitur në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.</p> <p>Ky format i cili përmban të gjitha elementet përbërëse të domosdoshme për kryerjen e pagës mujore të punonjësit, të plotësohet i veçantë për punonjësit organikë dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme pune.</p> <p>Për efekt të unifikimit ky format të plotësohet duke mbajtur në konsideratë që muaji ka 22 ditë pune.</p>																									

SHTOJCA NR. 5
KLASIFIKIMI I NJËSIVE VENDORE SIPAS NUMRIT TË POPULLSISË DHE KUFIRIT TË SHPENZIMEVE TË PERSONELIT
ADMINISTRATIV

Emërtimi	Njësitë vendore		Nr. i popullsisë	% e transfertës së pakushtëzuar e lejueshme, për mbulimin e kostos së personelit administrativ
Rrethi Berat				
Berat	Berat	B	63,087	deri në 15%
Berat	Ura-Vajgurore	B	11,796	deri në 25%
Berat	Poshnjë	K	10,072	deri në 35%
Berat	Kutalli	K	13,005	deri në 35%
Berat	Otilak	K	14,532	deri në 35%
Berat	Lumas	K	6,922	deri në 40%
Berat	Sinjë	K	5,416	deri në 40%
Berat	Tërpan	K	2,759	deri në 45%
Berat	Velabisht	K	11,635	deri në 35%
Berat	Vertop	K	7,303	deri në 40%
Berat	Roshnik	K	3,998	deri në 40%
Berat	Cukalat	K	4,344	deri në 40%
Rrethi Bulqizë				
Bulqizë	Bulqizë	B	12,335	deri në 25%
Bulqizë	Fushë-Bulqizë	K	4,024	deri në 40%
Bulqizë	Trebisht	K	1,315	deri në 45%
Bulqizë	Ostren	K	3,636	deri në 40%
Bulqizë	Shupenzë	K	6,715	deri në 40%
Bulqizë	Gjoricë	K	5,243	deri në 40%
Bulqizë	Zerqan	K	5,163	deri në 40%
Bulqizë	Martanesh	K	2,465	deri në 45%
Rrethi Delvinë				
Delvinë	Delvinë	B	14,248	deri në 25%
Delvinë	Vergo	K	4,083	deri në 40%
Delvinë	Finiq	K	6,763	deri në 40%
Delvinë	Mesopotam	K	6,335	deri në 40%
Rrethi Devoll				
Devoll	Bilisht	B	10,010	deri në 25%
Devoll	Miras	K	10,577	deri në 35%
Devoll	Qendër-Bilisht	K	8,909	deri në 40%
Devoll	Hoçisht (Moravë)	K	7,052	deri në 40%
Devoll	Progër	K	6,032	deri në 40%
Rrethi Dibër				
Dibër	Peshkopi	B	18,663	deri në 25%
Dibër	Qënder Tomin	K	8,566	deri në 40%
Dibër	Melan	K	4,479	deri në 40%
Dibër	Kastriot	K	7,424	deri në 40%
Dibër	Lurë	K	1,465	deri në 45%
Dibër	Maqellarë	K	13,346	deri në 35%
Dibër	Fushë Muhurr	K	3,467	deri në 40%
Dibër	Selishtë	K	1,948	deri në 45%
Dibër	Silovë	K	3,316	deri në 40%
Dibër	Kala e Dodës	K	3,133	deri në 40%
Dibër	Zall Dardhë	K	1,213	deri në 45%
Dibër	Zall Reç	K	1,137	deri në 45%
Dibër	Fushë-Çidhen	K	3,674	deri në 40%
Dibër	Arras	K	3,877	deri në 40%
Dibër	Luzni	K	3,163	deri në 40%
Rrethi Durrës				
Durrës	Durrës	B	202,913	deri në 15%
Durrës	Shijak	B	12,933	deri në 25%
Durrës	Manëz	B	11,117	deri në 25%
Durrës	Sukth	B	25,684	deri në 20%
Durrës	Rashbull	K	27,918	deri në 30%
Durrës	Xhafzotaj	K	17,554	deri në 30%
Durrës	Gjepalaj	K	5,784	deri në 40%



Durrës	Katund i Ri	K	15,322	deri në 30%
Durrës	Maminas	K	7,000	deri në 40%
Durrës	Ishëm	K	8,661	deri në 40%
Rrethi Elbasan				
Elbasan	Elbasan	B	123,998	deri në 15%
Elbasan	Cërrik	B	14,830	deri në 25%
Elbasan	Belsh	B	13,953	deri në 25%
Elbasan	Bradashesh	K	12,462	deri në 35%
Elbasan	Funar	K	3,108	deri në 40%
Elbasan	Gostimë	K	12,415	deri në 35%
Elbasan	Gracen	K	2,529	deri në 45%
Elbasan	Grekan	K	5,016	deri në 40%
Elbasan	Gjinar	K	4,910	deri në 40%
Elbasan	Gjergjan	K	7,603	deri në 40%
Elbasan	Kajan	K	6,466	deri në 40%
Elbasan	Fierzë	K	3,739	deri në 40%
Elbasan	Klos	K	4,202	deri në 40%
Elbasan	Labinot-Mal	K	5,642	deri në 40%
Elbasan	Labinot-Fushë	K	6,392	deri në 40%
Elbasan	Mollas	K	7,712	deri në 40%
Elbasan	Papër	K	8,975	deri në 40%
Elbasan	Rrasë	K	2,340	deri në 45%
Elbasan	Shalëz	K	6,883	deri në 40%
Elbasan	Shirgjan	K	9,922	deri në 40%
Elbasan	Shushicë	K	10,644	deri në 35%
Elbasan	Tregan	K	4,400	deri në 40%
Elbasan	Zavalinë	K	1,978	deri në 45%
Rrethi Fier				
Fier	Fier	B	85,555	deri në 15%
Fier	Patos	B	31,406	deri në 20%
Fier	Roskovec	B	8,563	deri në 25%
Fier	Mbrostar	K	10,332	deri në 35%
Fier	Libofshë	K	10,283	deri në 35%
Fier	Dermenas	K	12,375	deri në 35%
Fier	Topojë	K	7,554	deri në 40%
Fier	Levan	K	17,305	deri në 30%
Fier	Frakull	K	10,419	deri në 35%
Fier	Portëz	K	11,212	deri në 35%
Fier	Qendër (Çlirim)	K	12,037	deri në 35%
Fier	Ruzhdie	K	3,290	deri në 40%
Fier	Zharrëz	K	8,219	deri në 40%
Fier	Kurjan	K	5,325	deri në 40%
Fier	Kuman	K	8,288	deri në 40%
Fier	Strumë	K	9,047	deri në 40%
Fier	Cakran	K	16,433	deri në 30%
Rrethi Gramsh				
Gramsh	Gramsh	B	13,138	deri në 25%
Gramsh	Pishaj	K	6,440	deri në 40%
Gramsh	Kodovjat	K	3,304	deri në 40%
Gramsh	Kukur	K	3,456	deri në 40%
Gramsh	Skëndërbegas	K	2,272	deri në 45%
Gramsh	Poroçan	K	1,845	deri në 45%
Gramsh	Lënie	K	1,070	deri në 45%
Gramsh	Tunjë	K	2,218	deri në 45%
Gramsh	Sult	K	1,381	deri në 45%
Gramsh	Kushovë	K	1,054	deri në 45%
Rrethi Gjirokastër				
Gjirokastër	Gjirokastër	B	33,646	deri në 20%
Gjirokastër	Libohovë	B	3,393	deri në 25%
Gjirokastër	Qendër Libohovë	K	2,688	deri në 45%
Gjirokastër	Odrje	K	1,395	deri në 45%
Gjirokastër	Lunxhëri	K	5,739	deri në 40%

Gjirokastrë	Antigonë	K	1,593	deri në 45%
Gjirokastrë	Lazarat	K	3,389	deri në 40%
Gjirokastrë	Cepo	K	4,691	deri në 40%
Gjirokastrë	Picar	K	2,016	deri në 45%
Gjirokastrë	Dropull i Poshtëm	K	9,557	deri në 40%
Gjirokastrë	Dropull i Sipërm	K	10,563	deri në 35%
Gjirokastrë	Pogon	K	3,133	deri në 40%
Gjirokastrë	Zagorie	K	1,191	deri në 45%
Rrethi Has				
Has	Krumë	B	7,460	deri në 25%
Has	Golaj	K	7,900	deri në 40%
Has	Fajzë	K	4,153	deri në 40%
Has	Gjinaj	K	1,319	deri në 45%
Rrethi Kavajë				
Kavajë	Kavajë	B	39,280	deri në 20%
Kavajë	Rrogozhinë	B	11,573	deri në 25%
Kavajë	Lekaj	K	9,269	deri në 40%
Kavajë	Luz i Vogël	K	10,188	deri në 35%
Kavajë	Helmës	K	4,939	deri në 40%
Kavajë	Kryevidh	K	8,925	deri në 40%
Kavajë	Synej	K	10,600	deri në 35%
Kavajë	Golem	K	12,143	deri në 35%
Kavajë	Sinaballaj	K	1,819	deri në 45%
Kavajë	Gosë	K	8,151	deri në 40%
Rrethi Kolonjë				
Kolonjë	Ersekë	B	7,026	deri në 25%
Kolonjë	Leskovik	B	2,575	deri në 25%
Kolonjë	Qendër	K	4,112	deri në 40%
Kolonjë	Mollas	K	3,457	deri në 40%
Kolonjë	Çlirim	K	791	deri në 45%
Kolonjë	Barmash	K	863	deri në 45%
Kolonjë	Piskal-Novoselë	K	704	deri në 45%
Kolonjë	Qendër Leskovik	K	905	deri në 45%
Rrethi Korçë				
Korçë	Korçë	B	86,923	deri në 15%
Korçë	Maliq	B	7,946	deri në 25%
Korçë	Voskopojë	K	2,676	deri në 45%
Korçë	Lekas	K	958	deri në 45%
Korçë	Vithkuq	K	2,583	deri në 45%
Korçë	Liqenas	K	5,190	deri në 40%
Korçë	Pojan	K	17,066	deri në 30%
Korçë	Vreshtas	K	10,443	deri në 35%
Korçë	Libonik	K	13,800	deri në 35%
Korçë	Pirg	K	9,938	deri në 40%
Korçë	Gore	K	2,864	deri në 45%
Korçë	Moglicë	K	1,446	deri në 45%
Korçë	Voskop	K	6,008	deri në 40%
Korçë	Drenovë	K	10,527	deri në 35%
Korçë	Mollas	K	6,598	deri në 40%
Korçë	Qendër Bulgarec	K	13,896	deri në 35%
Rrethi Krujë				
Krujë	Krujë	B	16,201	deri në 25%
Krujë	Fushë-Krujë	B	24,788	deri në 20%
Krujë	Nikël	K	9,887	deri në 40%
Krujë	Bubq	K	8,228	deri në 40%
Krujë	Kodër Thumanë	K	15,351	deri në 30%
Krujë	Cudhi	K	3,229	deri në 40%
Rrethi Kuçovë				
Kuçovë	Kuçovë	B	30,059	deri në 20%
Kuçovë	Perondi	K	10,445	deri në 35%
Kuçovë	Kozarë	K	7,893	deri në 40%
Rrethi Kukës				



Kukës	Kukës	B	21,729	deri në 20%
Kukës	Malzi	K	3,942	deri në 40%
Kukës	Bicaj	K	6,293	deri në 40%
Kukës	Ujmisht	K	2,335	deri në 45%
Kukës	Tërthorë	K	3,296	deri në 40%
Kukës	Shtiqën	K	3,610	deri në 40%
Kukës	Zapod	K	3,097	deri në 40%
Kukës	Shishtavec	K	5,195	deri në 40%
Kukës	Topojan	K	2,635	deri në 45%
Kukës	Bushttricë	K	1,511	deri në 45%
Kukës	Surroj	K	1,479	deri në 45%
Kukës	Arren	K	736	deri në 45%
Kukës	Kolsh	K	1,563	deri në 45%
Kukës	Kalis	K	1,321	deri në 45%
Kukës	Grykë-Çaje	K	1,336	deri në 45%
Rrethi Kurbin				
Kurbin	Laç	B	29,342	deri në 20%
Kurbin	Mamurras	B	22,569	deri në 20%
Kurbin	Milot	K	11,928	deri në 35%
Kurbin	Fushë-Kuqe	K	8,608	deri në 40%
Rrethi Lezhë				
Lezhë	Lezhë	B	27,863	deri në 20%
Lezhë	Zejmen	K	9,120	deri në 40%
Lezhë	Shënkoll	K	15,340	deri në 30%
Lezhë	Shëngjin	K	11,573	deri në 35%
Lezhë	Kolsh	K	6,665	deri në 40%
Lezhë	Ballëdren i Ri	K	10,288	deri në 35%
Lezhë	Kallmet	K	6,942	deri në 40%
Lezhë	Ungrej	K	3,178	deri në 40%
Lezhë	Dajç	K	6,952	deri në 40%
Lezhë	Blinisht	K	5,492	deri në 40%
Rrethi Librazhd				
Librazhd	Librazhd	B	10,612	deri në 25%
Librazhd	Prenjas	B	8,558	deri në 25%
Librazhd	Qukës	K	10,676	deri në 35%
Librazhd	Stravaj	K	3,053	deri në 40%
Librazhd	Hotolisht	K	6,994	deri në 40%
Librazhd	Polis	K	5,107	deri në 40%
Librazhd	Qendër	K	11,236	deri në 35%
Librazhd	Lunik	K	3,676	deri në 40%
Librazhd	Orenjë	K	5,167	deri në 40%
Librazhd	Stëblevë	K	1,095	deri në 45%
Librazhd	Rrajcë	K	10,279	deri në 35%
Rrethi Lushnjë				
Lushnjë	Lushnjë	B	53,417	deri në 15%
Lushnjë	Divjakë	B	13,574	deri në 25%
Lushnjë	Ballagat	K	3,582	deri në 40%
Lushnjë	Hysgjokaj	K	3,539	deri në 40%
Lushnjë	Golem	K	7,577	deri në 40%
Lushnjë	Fier Shegan	K	9,270	deri në 40%
Lushnjë	Karbunarë	K	5,487	deri në 40%
Lushnjë	Allkaj	K	6,128	deri në 40%
Lushnjë	Krutje	K	10,189	deri në 35%
Lushnjë	Bubullimë	K	7,103	deri në 40%
Lushnjë	Kolonjë	K	8,374	deri në 40%
Lushnjë	Gradishtë	K	10,630	deri në 35%
Lushnjë	Rremas	K	6,515	deri në 40%
Lushnjë	Grabian	K	6,327	deri në 40%
Lushnjë	Tërbuf	K	15,251	deri në 30%
Lushnjë	Dushk	K	11,244	deri në 35%
Rrethi Malësi e Madhe				
Malësi e Madhe	Koplik	B	10,968	deri në 25%

Malësi e Madhe	Qendër	K	5,864	deri në 40%
Malësi e Madhe	Kelmend	K	6,257	deri në 40%
Malësi e Madhe	Kastrat	K	11,973	deri në 35%
Malësi e Madhe	Shkrelë	K	5,891	deri në 40%
Malësi e Madhe	Gruemirë	K	12,658	deri në 35%
Rrethi Mallakastër				
Mallakastër	Ballsh	B	11,689	deri në 25%
Mallakastër	Qendër	K	8,826	deri në 40%
Mallakastër	Hekal	K	4,810	deri në 40%
Mallakastër	Aranitas	K	4,480	deri në 40%
Mallakastër	Fratar	K	5,013	deri në 40%
Mallakastër	Kute	K	3,378	deri në 40%
Mallakastër	Kapaj	K	1,723	deri në 45%
Mallakastër	Ngracan	K	992	deri në 45%
Mallakastër	Greshicë	K	2,044	deri në 45%
Rrethi Mat				
Mat	Burrel	B	16,841	deri në 25%
Mat	Klos	B	10,159	deri në 25%
Mat	Komsi	K	5,225	deri në 40%
Mat	Ulëz	K	1,997	deri në 45%
Mat	Baz	K	3,220	deri në 40%
Mat	Rukaj	K	3,670	deri në 40%
Mat	Derjan	K	1,552	deri në 45%
Mat	Macukull	K	2,011	deri në 45%
Mat	Lis	K	4,798	deri në 40%
Mat	Suç	K	3,492	deri në 40%
Mat	Gurë	K	4,060	deri në 40%
Mat	Xibër	K	3,427	deri në 40%
Rrethi Mirditë				
Mirditë	Rrëshen	B	14,165	deri në 25%
Mirditë	Rubik	B	7,983	deri në 25%
Mirditë	Kaçinar	K	2,109	deri në 45%
Mirditë	Orosh	K	3,285	deri në 40%
Mirditë	Fan	K	4,757	deri në 40%
Mirditë	Kthellë	K	3,209	deri në 40%
Mirditë	Selitë	K	2,100	deri në 45%
Rrethi Peqin				
Peqin	Peqin	B	9,142	deri në 25%
Peqin	Gjocaj	K	7,049	deri në 40%
Peqin	Karinë	K	1,797	deri në 45%
Peqin	Pajovë	K	8,688	deri në 40%
Peqin	Përparim	K	5,403	deri në 40%
Peqin	Shezë	K	5,292	deri në 40%
Rrethi Përmet				
Përmet	Përmet	B	10,366	deri në 25%
Përmet	Këlcyrë	B	5,083	deri në 25%
Përmet	Çarshovë	K	3,104	deri në 40%
Përmet	Qendër Piskovë	K	2,844	deri në 45%
Përmet	Sukë	K	2,684	deri në 45%
Përmet	Ballaban	K	2,217	deri në 45%
Përmet	Deshnicë	K	2,721	deri në 45%
Përmet	Frashër	K	1,364	deri në 45%
Përmet	Petran	K	3,122	deri në 40%
Rrethi Pogradec				
Pogradec	Pogradec	B	38,687	deri në 20%
Pogradec	Buçimas	K	17,294	deri në 30%
Pogradec	Hudënisht	K	7,573	deri në 40%
Pogradec	Proptisht	K	6,566	deri në 40%
Pogradec	Velçan	K	3,726	deri në 40%
Pogradec	Trebinjë	K	3,477	deri në 40%
Pogradec	Dardhas	K	3,459	deri në 40%
Pogradec	Çërravë	K	9,761	deri në 40%



Rrethi Pukë					
Pukë	Pukë	B	5,406		deri në 25%
Pukë	Fushë-Arrëz	B	4,484		deri në 25%
Pukë	Qerret	K	3,187		deri në 40%
Pukë	Qelëz	K	2,505		deri në 45%
Pukë	Gjegjan	K	4,390		deri në 40%
Pukë	Fierzë	K	2,051		deri në 45%
Pukë	Iballë	K	2,191		deri në 45%
Pukë	Blerim	K	1,590		deri në 45%
Pukë	Qafë-Mali	K	2,332		deri në 45%
Pukë	Rrapë	K	1,820		deri në 45%
Rrethi Sarandë					
Sarandë	Sarandë	B	40,450		deri në 20%
Sarandë	Konispol	B	3,059		deri në 25%
Sarandë	Lukovë	K	9,574		deri në 40%
Sarandë	Dhivër	K	6,614		deri në 40%
Sarandë	Livadhja	K	10,411		deri në 35%
Sarandë	Xarrë	K	7,571		deri në 40%
Sarandë	Markat	K	3,120		deri në 40%
Sarandë	Ksamil	K	9,181		deri në 40%
Sarandë	Aliko	K	8,930		deri në 40%
Rrethi Skrapar					
Skrapar	Çorovodë	B	6,564		deri në 25%
Skrapar	Polican	B	8,625		deri në 25%
Skrapar	Qendër	K	4,406		deri në 40%
Skrapar	Potom	K	1,163		deri në 45%
Skrapar	Leshnjë	K	750		deri në 45%
Skrapar	Cepan	K	1,161		deri në 45%
Skrapar	Vendreshe	K	1,604		deri në 45%
Skrapar	Bogovë	K	1,696		deri në 45%
Skrapar	Zhepë	K	1,119		deri në 45%
Skrapar	Gjërbes	K	1,418		deri në 45%
Rrethi Shkodër					
Shkodër	Shkodër	B	113,185		deri në 15%
Shkodër	Vau i Dejës	B	12,610		deri në 25%
Shkodër	Postribë	K	11,398		deri në 35%
Shkodër	Pult	K	3,137		deri në 40%
Shkodër	Shosh	K	1,573		deri në 45%
Shkodër	Shalë	K	4,036		deri në 40%
Shkodër	Shllak	K	1,755		deri në 45%
Shkodër	Gur i Zi	K	11,258		deri në 35%
Shkodër	Vig-Mnelë	K	2,593		deri në 45%
Shkodër	Hajmel	K	6,357		deri në 40%
Shkodër	Bushat (new)	K	23,197		deri në 30%
Shkodër	Bërdicë	K	9,149		deri në 40%
Shkodër	Velipojë	K	8,910		deri në 40%
Shkodër	Dajç (Bregbune)	K	8,725		deri në 40%
Shkodër	Ana e Malit	K	5,799		deri në 40%
Shkodër	Rrethinat	K	23,001		deri në 30%
Shkodër	Temal	K	2,326		deri në 45%
Rrethi Tepelenë					
Tepelenë	Tepelenë	B	8,179		deri në 25%
Tepelenë	Memaliaj	B	7,201		deri në 25%
Tepelenë	Qendër	K	5,885		deri në 40%
Tepelenë	Fshat Memaliaj	K	2,729		deri në 45%
Tepelenë	Krahëz	K	4,232		deri në 40%
Tepelenë	Qesarat	K	2,484		deri në 45%
Tepelenë	Luftinjë	K	3,985		deri në 40%
Tepelenë	Buz	K	1,527		deri në 45%
Tepelenë	Kurvelesh	K	1,324		deri në 45%
Tepelenë	Lopez	K	1,152		deri në 45%
Rrethi Tiranë					

Tiranë	Tiranë	B	620,540	deri në 15%
Tiranë	Vorë	B	18,789	deri në 25%
Tiranë	Kamëz	B	80,471	deri në 15%
Tiranë	Petrelë	K	6,426	deri në 40%
Tiranë	Bërzhitë	K	5,790	deri në 40%
Tiranë	Baldushk	K	5,307	deri në 40%
Tiranë	Zall Bastar	K	5,523	deri në 40%
Tiranë	Shëngjergj	K	2,778	deri në 45%
Tiranë	Dajt	K	12,381	deri në 35%
Tiranë	Vaqarr	K	9,083	deri në 40%
Tiranë	Pezë	K	5,669	deri në 40%
Tiranë	Ndroq	K	9,133	deri në 40%
Tiranë	Prezë	K	6,675	deri në 40%
Tiranë	Zall Herr	K	10,677	deri në 35%
Tiranë	Paskuqan	K	39,359	deri në 30%
Tiranë	Bërxullë	K	9,777	deri në 40%
Tiranë	Kashar	K	21,793	deri në 30%
Tiranë	Farkë	K	11,770	deri në 35%
Tiranë	Krrabë	K	3,077	deri në 40%
Rrethi Tropojë				
Tropojë	Bajram Curri	B	8,202	deri në 25%
Tropojë	Fshat Tropojë	K	5,463	deri në 40%
Tropojë	Bytyç	K	2,090	deri në 45%
Tropojë	Lekbibaj	K	1,976	deri në 45%
Tropojë	Fierzë	K	2,388	deri në 45%
Tropojë	Margegaj	K	2,979	deri në 45%
Tropojë	Bujan	K	2,947	deri në 45%
Tropojë	Llugaj	K	2,181	deri në 45%
Rrethi Vlorë				
Vlorë	Vlorë	B	135,325	deri në 15%
Vlorë	Orikum	B	11,452	deri në 25%
Vlorë	Selenicë	B	6,978	deri në 25%
Vlorë	Himarë	B	13,193	deri në 25%
Vlorë	Qendër	K	18,417	deri në 30%
Vlorë	Novoselë	K	16,490	deri në 30%
Vlorë	Brataj	K	5,038	deri në 40%
Vlorë	Hore Vranisht	K	4,110	deri në 40%
Vlorë	Shushicë	K	9,395	deri në 40%
Vlorë	Vllahinë	K	7,306	deri në 40%
Vlorë	Kote	K	6,616	deri në 40%
Vlorë	Sevastar	K	3,273	deri në 40%
Vlorë	Armen	K	6,811	deri në 40%



SHTOJCA NR. 6

NJËSIA E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME
RAPORTIMI I FINANCIMEVE TË HUAJA PËR VITIN 2012, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 775, DATË 24.9.2010
DHE UDHËZIMIT TË MINISTRISË SË FINANCEVE

Kredi grand	Kreditori donatori	Projekti	Data e fillimit të projektit	Data e përfundimit. të projektit	Mënyra e financimit natyrë/ vlerë	Mone dha	Vlera e projektit	Disbursimet deri më		Shpenzimet deri më 31.12.2007			
								31.12.2007		Totali progresiv		Nga kjo në 2007	
								Totali progresiv	Nga kjo 2007	Art. 230	Art. 231	Art. 230	Art. 231

DREJTORI

FINANCIERI

SHTOJCA NR. 7
RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE BUXHETORE

Grupi							Kodi
Programi							Titulli
Artikulli Kodi	Emri	Totali Shpenzimeve					(5) = (2)-(4) Diferenca 2008
		(1) MTBP plan 2008	(2) Buxheti 2008	(3) Buxheti i rishikuar 2008	(4) Fakti 2008		
600	Paga						
601	Sigurime shoqërore						
602	Mallra dhe shërbime të tjera						
603	Subvencione						
604	Transferata korente të brendshme						
605	Transferata korente të huaja						
606	Trans per buxh. fam. dhe individ						
Nëntotali	Shpenzime korrente	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
230	Kapitale të patrupëzuara						
231	Kapitale të trupëzuara						
232	Transferata kapitale						
Nëntotali	Shpenzime kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali	Korrente dhe kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Jashtë buxhetore							
Totali (korrente + kapitale + jashtëbuxhetore)		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Drejtuesi i ekipit menaxhues të programit	Emri		Sekretari i përgjithshëm	Emri			
	Firma			Firma			
	Data			Data			

SHTOJCA NR. 8
RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

Emri i grupit						Kodi i grupit
Programet Titulli	Emri	Shpenzimet e Ministrisë				
		PBA plan 2008	Buxhet 2008	Fakti 2008	Diferenca 2008	
0001	Programi 1	0.0	0.0	0.0	0.0	
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali i shpenzimeve të ministrisë		0.0	0.0	0.0	0.0	

Sekretari i Përgjithshëm	Emri	
	Firma	
	Data	



SHTOJCA NR. 9
RAPORTI I REALIZIMIT TË REZULTATEVE TË PROGRAMIT

Grupi		Kodi						
Programi		Titulli						
Kodi i rezultatit	Emri i rezultatit	Njësia matëse	Sasia e planifikuar	Sasia e realizuar	Realizimi			Komente
					Plotësisht	Pjesërisht	Aspak	
A	Rezultati A							
B	Rezultati B							
C	Rezultati C							
D	Rezultati D							
E	Rezultati E							

Drejtuesi i ekipit menaxhues të programit	Emri		Sekretari i Përgjithshëm	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	

SHTOJCA NR. 10
RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS REZULTATEVE

Grupi		Kodi				
Programi		Titulli				
				Shpenzimet e rezultatit		
Kodi i rezultatit	Emri i rezultatit	PBA plan 2008	Buxhet 2008	Fakti 2008		
A	Rezultati A	0.0	0.0	0.0		
B	Rezultati B	0.0	0.0	0.0		
C	Rezultati C	0.0	0.0	0.0		
D	Rezultati D	0.0	0.0	0.0		
E	Rezultati E	0.0	0.0	0.0		

Drejtuesi i ekipit menaxhues të programit	Emri		Sekretari i Përgjithshëm	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	

SHTOJCA NR. 11
PROJEKTET ME FINANCIM TË BRENDSHËM
000/ lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Buxheti
			Kontraktuar

PROJEKTET ME FINANCIM TË HUAJ

000/ lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Grand/ kredi	Vlera e plotë e projektit	Shpenzimi i realizuar

SHTOJCA NR. 12
RAPORTIMI I FONDIT TË PAGAVE DHE NUMRIT TË PUNONJËSVE TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE

Emri i njësisë	Viti 2009 (fakti)		Viti 2010	
	Numri i punonjësve	Fondi i pagave (në lekë)	Numri i punonjësve	Fondi i pagave (në lekë)
Administrata e njësisë	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjës me kontratë (administrata)	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucionet e varësisë	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjës me kontratë (institucionet e varësisë)	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	0.0	0.0	0.0	0.0



SHTOJCA NR.13: SHKRESA E NJËSIVE VENDORE PËR HAPJE LLOGARIE HUAMARRJEJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSIME E THESARIT
DREJTORIA OPERACIONALE

Nr. 13/2010 Prot.

Tirane, më 22.04.2010

Per: **BANKA KOMBETARE TREGTARE**

Per njoftim: **Dega e Thesarit Elbasan
Bashkia Elbasan**


Subjekti: **Kerkese per hapje llogarie**

Ne zbatim te Ligjit Nr.9869, dt.04.02.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" si dhe Udhhezimit te Ministrise se Financave Nr.35, dt. 05.04.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", lutemi te hapni prane Bankes Kombetare Tregtare Dega Elbasan, llogarine tranzite per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore: "Dega e Thesarit Elbasan-Huamarrje Njesia Vendore" ne LEKE.

Kjo llogari du te funksionoje ne perputhje me Akt-Marrovshjen midis Ministrise se Financave dhe Bankes tuaj.

Pas hapjes se kesaj llogarie, lutemi njoftoni numrin e saj IBAN prane Degas se Thesarit Elbasan dhe Ministrise se Financave - Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit - Drejtoria Operacionale,

Ridvan BODE



SHTOJCA 14/1: FORMATI I RAPORTIMIT TË AKTIVEVE NË PRONËSI
OBJEKTET SHTETËRORE TË DHËNA ME QIRA NGA NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME
MINISTRIA/INSTITUCIONI _____

Nr.	Emërtimi i objekteve të dhëna me qira	Sip. objek. m ²	Afati i qirasë	Veprimtaria që kryhet	Qiraja mujore	Arkëtimet					Adresa e plotë e subjektit përfitues të objektit me qira
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	xxx	
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											



SHTOJCA 14/2: FORMATI I RAPORTIMIT TË AKTIVEVE NË PRONËSI
TË DHËNA PËR SUBJEKTET/NDËRMARRJET/KOMPANITË ETJ. ME KAPITAL TËRËSISHT/PJESËRISHT SHTETËROR
MINISTRIA E _____

Emërtimi Subjek./ndërm./kompani/etj.	Statusi sha, shpk, ndërm, etj.	Pjesëmarrja e shtetit %	Nipti subjek/ndërm/ kompani/etj	Dividenti			Adresa e plotë e qendrës së Subjektit, ndërmarrjes, kompanisë apo formave të tjera të parashikuara me ligj
				Viti raportues		Viti planif	
				Realizuar	Derdhur	Parash	
b	c	d	e				f
SHUMA							

SHTOJCA 14/3: FORMATI I RAPORTIMIT TË AKTIVEVE NË PRONËSI
PASQYRA PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE TË DHËNA ME KONCESION
MINISTRIA E _____

Nr.	Shoqëria koncesionare	Objekti i koncesionit	Nipti	Afati konces. në vite	Kushti bazë i pagesës	Fillimi i pagesës	Arkëtuar			Adresa e plotë e selisë së shoqërisë koncesionare nr. kontakti tel. cel	
							Deri në vitin xxx	Viti raportues			Viti pl Parash
								Llog.	Derdh.		
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											
16											
17											
18											



URDHËR
Nr. 83, datë 10.2.2012

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHITJES SË PRODUKTEVE HIDROKARBURE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të aktit normativ nr. 2, datë 18.6.2010 “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, miratuar me ligjin nr. 10 298, datë 8.7.2010, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos të shesë produktet hidrokarbure, për tregun vendas dhe/ose për eksport, duke përcaktuar sasinë dhe cilësinë e produktit që do të shitet sipas procedurave të këtij urdhri.

Procedurat e shitjes janë si më poshtë:

1. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos është përgjegjëse për shitjen me ankand me anën e procedurës së hapur të produkteve hidrokarbure për tregun vendas me qëllim përpunimin e tyre dhe/ose për eksport.

2. Procedura e shitjes së produkteve hidrokarbure do të fillojë kur shoqëria të ketë të depozituara 20 000 (njëzet mijë) deri në 30 000 (tridhjetë mijë) tonë produkte hidrokarbure (naftë bruto), pavarësisht se kjo sasi është krijuar nga vetë prodhimi i shoqërisë apo nga përfitimi që shoqëria merr nga marrëveshjet hidrokarbure (prodhimi paraekzistues dhe pjesa e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos).

3. Me krijimin e sasisë së përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri, titullari i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos, njofton Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), si dhe pret miratimin e saj për fillimin e procedurës së shitjes. Pas miratimit nga METE, titullari i shoqërisë nxjerr urdhrin për shitjen me ankand me anën e procedurës së hapur të kësaj sasive produkti hidrokarbur (naftë bruto).

4. Në urdhër përcaktohet:

- sasia e produkteve hidrokarbure (naftë bruto), që do të shitet;
- çmimi/njësi fillestar i ankandit;
- procedura e hapur;
- emrat e anëtarëve të komisionit të shitjes.

Një kopje e këtij urdhri dërgohet për informim në METE.

5. Shitja e produkteve hidrokarbure (naftës bruto) për tregun vendas me qëllim përpunimin e tyre dhe/ose për eksport, do të bëhet sipas çmimit të Bursës Ndërkombëtare për hidrokarburet (Bursës Ndërkombëtare Brent).

6. Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për Brentin, në momentin e përlogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi sipas cilësisë së produktit të prodhuar, dhe përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes. Në çdo rast, çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes duhet të jetë më i lartë se çmimi i shitjes i programuar nga “Albpetrol” sh.a. për vitin përkatës.

7. Për nxjerrjen e të dhënave, sipas pikës 6, krijohet grup ekspertësh të fushës, të propozuar nga “Albpetrol” sh.a., dhe të miratuar nga Ministri. Grupi i ekspertëve duhet të përbëhet nga 3 deri në 5 persona.

8. Komisioni i shitjes administron të gjithë procedurën e shitjes. Komisioni do të ketë një përbërje prej 5 (pesë) anëtarësh, përfshirë dhe kryetarin.

Kryetari i komisionit të shitjes duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit shitës dhe përgjigjet për fillimin e punës menjëherë pas daljes së urdhrin të ankandit.

Anëtarët e komisionit duhet të jenë me arsim të lartë dhe njëri prej tyre duhet të jetë jurist.

Ky komision është përgjegjës:

- për sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në shoqëri;
- për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për botim brenda afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ankandin publik;
- për hartimin e urdhrave të ankandit;
- për mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen dokumenteve të ankandit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve;
- për llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të ankandit, që u jepen ofertuesve;
- për hartimin e dokumenteve të ankandit, në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi;
- për kërkesat për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit;
- për specifikimet teknike.

9. Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve duhet të mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti shitës duhet të përdorë dokumentet standarde të ankandit.

Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit të shitjes, që i kanë hartuar ato.

10. Kërkesat ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh përpara emërimit të një nëpunësi në komision.

Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e ankandit, përpara hapjes së ofertave, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Nuk lejohet që titullari i autoritetit shitës të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes.

11. Pas miratimit të dokumenteve të ankandit, titullari i autoritetit shitës apo nëpunësi i autorizuar, përcjell për botim njoftimin e ankandit dhe të dokumenteve të ankandit, në Buletinin e Njoftimeve Publike, në dy gazeta kombëtare, në faqen zyrtare të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Në këtë njoftim shënohen vendi, ora, data dhe adresa e dorëzimit dhe e hapjes së ofertave.

Në njoftim shënohet edhe se dokumentet e ankandit mund të tërhiqen në rrugë elektronike nga adresa zyrtare e APP-së.

Në ankandin publik lejohen të marrin pjesë ofertues/kandidatë, që i kanë tërhequr dokumentet drejtpërdrejt nga autoriteti shitës, si dhe ata, që i kanë tërhequr këto dokumente në rrugë elektronike, të cilët duhet të jenë të pajisur:

- me leje për përpunimin e produkteve hidrokarbure (naftë bruto) në tregun e brendshëm ose me licencën përkatëse të marrë në Shqipëri për tregtimin e këtyre produkteve hidrokarbure (naftë bruto), kur këto produkte do të përpunohen në Shqipëri;
 - me licencën përkatëse të marrë në Shqipëri ose në vendin e origjinës së shoqërisë për tregtimin e këtyre produkteve hidrokarbure (naftë bruto), kur këto produkte do të tregtohen për qëllim eksporti.¹
- Ofertues/kandidatë duhet gjithashtu të plotësojnë çdo kërkesë tjetër që i shërben transparencës dhe garancisë së transaksionit të ndërmarrë, përfshirë, por pa u kufizuar në paraqitjen e:
- bilancit financiar për tre vitet e fundit ose të garancisë bankare për transaksionin financiar që do të kryejë me shoqërinë “Albpetrol” sh.a. Patos;
 - ekstraktit historik dhe ekstraktit të regjistrimit të shoqërisë, nga QKR;
 - dokumentit për mospasjen e asnjë detyrimi financiar ndaj shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos;
 - dokumentit për mospasjen e asnjë detyrimi financiar ndaj organeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore;

¹ Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.



- vërtetimit nga përbarimi, prokuroria dhe gjykata, në lidhje me aktivitetin e shoqërisë;
- si dhe çdo dokument tjetër të përcaktuar në dokumentet e ankandit nga ana e komisionit të shitjes.

Komisioni i shitjes është përgjegjës për lëshimin e një kopjeje të dokumenteve të ankandit për çdo ofertues/kandidat.

Nëse një ofertues/kandidat ankohet për hartimin e dokumenteve të ankandit apo kërkon sqarim për to, autoritetit shitës, në çdo kohë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga afati përfundimtar i dorëzimit të ofertave, në përgjigje të tyre ose me nismën e vet mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit përmes hartimit të një shtojce.

Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë me shkrim të gjithë kandidatëve që kanë tërhequr dokumentet e ankandit pranë autoritetit shitës, si dhe në rrugë elektronike nga adresa zyrtare e APP-së dhe bëhet detyruese për ta.

Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e ankandit, autoriteti shitës e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, nga data e caktuar për dorëzimin e ofertës.

12. Komisioni përgatit formatin e dokumenteve standarde të ankandit, që do të përdoren gjatë procedurave të shitjes.

Këto dokumente japin:

i) informacione të përgjithshme; dhe

ii) informacion specifik, që ka lidhje me objektin e ankandit dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga shoqëria "Albpetrol" sh.a. Patos.

Gjatë përgatitjes së dokumenteve të ankandit, autoriteti shitës nuk duhet të përdorë asnjë dokument tjetër, përveç dokumenteve standarde.

Ato duhet të jenë gjithmonë në dispozicion të çdo ofertuesi/kandidati të interesuar, që dëshiron të marrë pjesë në këtë procedurë publike.

- Informacioni i përgjithshëm përfshin:

- a) formularin e njoftimit të ankandit;
- b) formularin e ftesës për ofertë;
- c) informacion mbi objektin e ankandit;
- ç) formularin e ofertës;
- d) formularin e sigurimit të kontratës;
- dh) kriteret për pjesëmarrje, kualifikim dhe vlerësim të ofertës;
- e) formularin e sigurimit të ofertës;
- ë) udhëzimet për zhvillimin e ankandit;
- f) formularin e njoftimit të fituesit;
- g) formularin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- gj) formularin e ankesës;
- h) kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të ankandit.

- Informacioni specifik përfshin:

- a) specifikimet teknike të naftës bruto;
- b) grafikun e zbatimit të kontratës;
- c) afatin përfundimtar të ekzekutimit të kontratës;
- d) kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

I- Informacioni i përgjithshëm

- a) Formulari i njoftimit të ankandit

Formulari i njoftimit të ankandit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për t'i lejuar ofertuesit/kandidatit të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e ankandit.

Ky informacion përfshin:

- emrin dhe adresën e autoritetit shitës dhe të personit/ave përgjegjës për procedurën;
- objektin, referencën e njoftimit dhe procedurën e ankandit;
- çmimin/njësi minimal fillestar të ankandit, një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose

LOTET, nëse përdoren;

- vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të ankandit;
- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;
- gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
- si dhe informacione të mëtejshme, të vlerësuara të dobishme nga autoriteti shitës.

b) Ftesa për ofertë

Ftesa për ofertë përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u krijojë mundësinë ofertuesve/kandidatëve të plotësojnë dhe dorëzojnë ofertat e tyre.

Ky informacion përfshin:

- një referencë për njoftimin e botuar;
- kriteret e shpalljes së fituesit;
- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertës dhe vendin, datën dhe orën për hapjen e tyre;
- gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
- si dhe ndonjë informacion të mëtejshëm, që është vlerësuar i dobishëm nga autoriteti shitës.

c) Informacioni mbi objektin e ankandit

Autoriteti shitës është i detyruar të vërë në dispozicion të çdo kandidati blerës informacionin e plotë mbi objektin e ankandit.

ç) Formulari i ofertës

Ky formular përmban vlerën e ofertës dhe konfirmimin e kandidatit/ofertuesit se:

- e ka shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e dokumenteve të ankandit;
- autorizon autoritetin shitës të verifikojë informacionin/dokumentet, që i bashkëlidhen ofertës;
- do të përmbushë kontratën pa asnjë rezervë ose kufizim, në përputhje me projektin specifikimet teknike apo termat e referencës, si dhe me vlerën e deklaruar në ofertë.

Ofertuesi duhet të deklarojë se oferta mbetet e vlefshme për 150 ditë nga data e fundit për dorëzim¹.

d) Formulari i sigurimit të kontratës

Sigurimi i kontratës garanton autoritetin shitës në rastet e refuzimit për të nënshkruar apo të shkeljes së kontratës.

Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit shitës një sigurim kontrate prej 10% të garancisë, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari².

Nëse ofertuesi/kandidati i përzgjedhur nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, të përcaktuar në njoftimin e fituesit, atëherë autoriteti shitës konfiskon sigurimin e ofertës dhe lidh kontratën me ofertuesin e renditur të dytë në klasifikimin përfundimtar.

dh) Kriteret dhe kushtet për pjesëmarrje, kualifikim dhe vlerësim të ofertës

Ky formular përmban listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti shitës, për të drejtën për të marrë pjesë në procesin e ankandit.

Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin, për të gjitha sa u thanë më sipër, një deklaratë me shkrim.

Kriteri bazë i vlerësimit do të jetë oferta me çmimin më të lartë.

e) Formularin e sigurimit të ofertës

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit", i ndryshuar

² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit", i ndryshuar



Ky formular shërben si masë mbrojtëse për autoritetin shitës, në rastet e ofertave të papërgjegjshme apo të tërheqjes së ofertave në mënyrë të njëanshme, pas hapjes së tyre.

Sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

Ofertuesit/kandidatët duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës fillestare të ankandit,¹ të përcaktuar në dokumentet e ankandit.

Sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 150 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Megjithatë në dokumentet e ankandit mund të parashikohet një periudhë e ndryshme vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës.

Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:

- të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;

- të paguajë shumën brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës zyrtare të autoritetit shitës, në llogarinë bankare të këtij të fundit.

Autoriteti shitës nuk e pretendon dhe duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë sigurimin e ofertës:

- ofertuesit/kandidatit fitues, jo më vonë se 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës;

- ofertuesit/kandidatit të pasuksesshëm, jo më vonë se 15 ditë nga data e publikimit të njoftimit të fituesit;

- në rastin kur janë anuluar procedurat e ankandit pa shpallur fitues.

ë) Udhëzimet për zhvillimin e ankandit

Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur, për përgatitjen e ofertës, si dhe veprimet, që ndalohen me ligj. Në to shpjegohet se pjesëmarrësit në procedurën e ankandit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të ankandit, pa bërë asnjë ndryshim.

Dokumentet e ankandit duhet të hartohen në gjuhën shqipe.

Në udhëzime përcaktohet se, nëse parashikohet një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë pjesëmarrësit në ankand duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit.

Gjithashtu, mund të organizohet edhe një takim paraprak, ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime, për ndonjë paqartësi, që u lind gjatë përgatitjes së dokumenteve.

Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit shitës duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë ofertuesve/kandidatëve, që kanë kërkuar dokumentet e ankandit.

Çdo ndryshim në dokumentet e ankandit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar. Udhëzimet japin informacion edhe për procedurën e rishikimit dhe të dorëzimit të ankesave.

f) Formulari i njoftimit të fituesit

Ofertuesi/kandidati i suksesshëm njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës.

Ky njoftim i dërgohet edhe APP-së për t'u botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Njoftimi duhet të përmbajë të paktën: referencën e procedurës, emrat e ofertuesve pjesëmarrës, emrin/at e ofertues-it/ve të skualifikuar, emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij.

g) Formulari i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve

Ky dokument përmban shkaqet pse një ofertues apo kandidat nuk mund të kualifikohet në një procedurë ankandi.

gj) Formulari i ankesës

Formulari ankesës u shërben ofertuesve/kandidatëve për dorëzimin e ankesës administrative, për veprimet a mosveprimet e autoritetit shitës.

Ky formular përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij dhe duhet të jetë i shpallur në faqen e internetit të APP-së.

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, date 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit", i ndryshuar

h) Kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të ankandit

Ky dokument përmban tërësinë e mallit që do të shitet, të drejtat dhe detyrimet, ndërmjet autoritetit shitës dhe blerësit, si dhe detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

13. Ofertat e shoqërive vendase apo të huaja që kërkojnë të marrin pjesë në procedurën konkurruese për blerjen e produkteve hidrokarbure do të paraqiten në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në ambientin, datën dhe orën e përcaktuar në ofertën e publikuar dhe njoftuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në METE, me marrjen e njoftimit nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos, merr të gjitha masat për sigurimin e ambientit dhe kushteve të përshtatshme për zhvillimin e ankandit.

Menjëherë pas skadimit të afatit përfundimtar, komisioni i shitjes fton përfaqësuesit e ofertuesve/kandidatëve të dorëzojnë ofertat të mbyllura në zarf dhe verifikon ato që janë dorëzuar më parë në një rën nga mënyrat e parashikuara në dokumentet e ankandit.

Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit shitës nuk shqyrtohet dhe i kthehet e papatur ofertuesit/kandidatit.

Me paraqitjen e ofertave, ofertuesit/kandidatët ftohen të nënshkruajnë deklaratën, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e komisionit të shitjes.

Dorëzimi i ofertave do të bëhet në praninë e komisionit të shitjes dhe nëpunësit të protokollit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Oferta duhet të përmbajë dokumentet kualifikuese të ofertuesit/kandidatit dhe ofertën ekonomike.

14. Komisioni i shitjes në orën e publikuar në njoftim hap ofertat:

- lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës;
- lexon me zë të lartë listën e dokumenteve ligjore, administrative dhe kualifikues të ofertuesit;
- hap zarfet e ofertave dhe bën kualifikimin e tyre duke filluar nga oferta më e lartë;
- fikson ofertën me çmimin më të lartë të paraqitur nga fituesi;
- përcakton hapin e dhënies së ofertave, bazuar në ofertën me çmimin më të lartë të kualifikuar për fillimin e konkurrimit;

- shpall personin e fundit që deklaron çmimin më të lartë, si fitues të ankandit.

Procesverbali dhe një vërtetim, që pasqyron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ofertën e tij duhet t’i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit, që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t’i dërgohet njoftim. Oferta ekonomike nënshkruhet në pjesën e pasme të fletës, nga të gjithë anëtarët e komisionit të shitjes.

Gabimet aritmetike ndiqen në mënyrën e mëposhtme:

- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

- Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.

- Nëse ofertuesi nuk pranon korrigjimin e gabimeve, oferta e tij refuzohet dhe sigurimi i ofertës konfiskohet.

Nëse është e nevojshme, komisioni i shitjes kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të reflektuara në procesverbalin e mbajtur me këtë rast.

Bazuar në ofertat e pranuar, komisioni i shitjes harton klasifikimin përfundimtar dhe e komunikon atë në kohën e përcaktuar.

Pas hapjes dhe leximit të ofertës, siç përcaktohet më lart, komisioni i shitjes, nëse gjykon se i nevojitet më shumë se një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij, vë në dijeni përfaqësuesit për orën dhe datën kur ofertuesve do t’u komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertës ekonomike, si dhe klasifikimin përfundimtar.

Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë 10 ditë.



Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i shitjes verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, të përcaktuara në dokumentet e ankandit dhe kriterin e vlerësimit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i shitjes kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të reflektuara në procesverbalin e ankandit.

Oferta e vlerësuar si më e larta do të shërbejë si vlerë fillestare për zhvillimin e procedurës së ankandit.

Komisioni i shitjes, pasi deklaron vlerën fillestare të ankandit pas hapjes së ofertave, deklaron hapin e dhënies së ofertave mbi vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand, si dhe drejton marrjen e ofertave nga pjesëmarrësit në ankand.

Vlefata e hapit të zhvillimit të ankandit do të jetë 2-5 për qind e vlerës fillestare të ankandit dhe vendoset nga komisioni i shitjes.

Në përfundim hartohet procesverbali i shitjes, i cili nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e komisionit të shitjes dhe ofertuesit në garë.

Komisioni i shitjes do të shpallë fitues ofertuesin që ka ofruar vlerën më të lartë në favor të autoritetit shitës.

Nëse ka dyshime për vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga kandidati blerës, atëherë autoriteti shitës verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesit.

Kryetari i komisionit të ankandit pas 5 ditësh nga komunikimi me ofertuesit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon, për miratim, titullarit të autoritetit shitës.

Pas miratimit të raportit përmbledhës nga titullari, autoriteti shitës dërgon një njoftim.

Çdo hap i procedurës së ankandit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbalin e ankandit.

Njëri nga anëtarët e komisionit të shitjes është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e njësisë.

Nëse anëtarët e komisionit kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal.

Dokumentet, që shoqërojnë ofertën, nuk iu kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen në përputhje me ligjin.

15. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, me përzgjedhje të blerësve duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme.¹

Në të kundërt, autoriteti shitës ndërpret procedurën dhe fillon një procedurë të re. Autoriteti shitës, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet, që shkaktojnë dështimin e procedurës, dhe i korrigjon ato në mënyrë, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës.

16. a) Ofertuesi fitues duhet të paraqitet për të lidhur kontratën brenda një periudhe jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të fituesit.

Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe autoriteti shitës.

Kontrata e shitjes do të përfshijë në çdo rast të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas kontratës tip, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Kur ofertuesi fitues nuk arrin të nënshkruajë kontratën brenda afatit të përcaktuar në pikën “a” më lart, ose nuk bën sigurimin e kontratës, autoriteti shitës bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

17. Për shoqërinë e shpallur fituese, autoriteti shitës nënshkruan kontratën, pasi ofertuesi fitues të ketë bërë sigurimin e kontratës në vlerën 10% të vlerës së ofruar.²

Në çdo kontratë shitjeje do të parashikohen penalitete për rastet e shkeljeve nga ana e blerësit sipas përcaktimeve të Kodit Civil.

18. Pagesa nga ofertuesi fitues për sasinë e kontraktuar do të bëhet sipas grafikut të livrimit të mallit të rënë dakord midis palëve, por me sasi jo më të vogël se 10 000 (dhjetë mijë) tonë produkt

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit”, i ndryshuar

² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit”, i ndryshuar

hidrokarbur (naftë bruto) të shitur, me transfertë bankare, në CASH, me letër krediti të parevokueshme, para fillimit të lëvrimit të secilës sasi.¹

19. Çdo kandidat/ofertues, që ka ose ka pasur interes në një procedurë ankandi, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit shitës, mund ta kundërshtojë këtë vendim.

- Gjatë procedurës së ankandit ankesat duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit shitës.

- Kundërshtimet duhet t'i adresohen titullarit të autoritetit shitës brenda 7 ditëve nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkelje të ligjit.

Ankimesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban emrin dhe adresën e ankimesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar.

Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

Nëse mungon ndonjëra nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti shitës duhet të vërë në dijeni ankimesin, që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në rregullat e ankandit publik.

Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe ato elektronike, dhe, në çdo rast, dokumentohet nga zyrtari përkatës.

Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 48 orëve pas njoftimit, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Përveç dokumenteve të ankandit, formulari duhet të vihet gjithmonë në dispozicion dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit të APP-së.

- Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimesi, titullari i autoritetit shitës urdhëron komisionin e shitjes të pezullojnë vazhdimin e procedurës, derisa ankesa të shqyrtohet plotësisht. Titullari i autoritetit shitës ia ngarkon çështjen një zyrtari apo zyre brenda autoritetit, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një rekomandim për titullarin.

Personi apo zyra e ngarkuar nuk duhet të ketë marrë pjesë në vendimmarrje, për të cilin është paraqitur ankesa.

Vendimi për ankesën duhet të merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj².

Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri pasi autoriteti shitës ta sigurojë këtë informacion.

Autoriteti shitës duhet të informojë ankimesin për vendimin dhe arsyet për këtë vendim të marrë, jo më vonë se 24 orë pas marrjes së vendimit.

Autoriteti shitës, nëse nevojitet, duhet të zgjasë afatin kohor të procedurës së ankandit aq sa zgjat periudha e pezullimit.

- Në rastet kur afatet kohore të procedurës së ankandit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti shitës u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.

20. Nëse autoriteti shitës nuk arrin ta shqyrtojë ankesën brenda afateve kohore, të përcaktuara në pikën 4 të nenit 42 të LAP-së ose e refuzon atë, atëherë ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në KPP, brenda 7 ditëve nga dita e parë e punës,³ pas skadimit të afatit kohor, ose, në rast se ankesa refuzohet nga autoriteti shitës, duke filluar nga dita kur ankimesi është vënë në dijeni për këtë refuzim.

- Gjatë procedurës së ankandit, KPP-ja nuk mund të shqyrtojë asnjë ankesë, nëse kjo nuk është dorëzuar më parë pranë autoritetit shitës.

- Ankimesi duhet të përdorë formularin standard të ankesës, që përmban emrin dhe adresën e ankimesit e të dhënat e tjera të kontaktit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar.

Elementet e sipërpërmendura janë thelbësore për shqyrtimin e ankesave dhe shmangien e ankesave të parregullta.

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit", i ndryshuar

² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit", i ndryshuar.

³ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit", i ndryshuar.



Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

Nëse mungon ndonjëra nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë KPP-ja duhet të vërë në dijeni ankimuesin, që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në rregullat e ankandit publik.

Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe ato elektronike, dhe në çdo rast, dokumentohet nga zyrtari përkatës.

Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 48 orëve pas njoftimit, ankesa vlerësohet si e paparaqitur.

Një kopje e shkruar e ankesës duhet t'i njoftohet menjëherë autoritetit shitës, i cili duhet të pezullojë procedurën e ankandit.

KPP-ja, me marrjen e ankesës me shkrim, kthen përgjigje brenda 7 (shtatë) ditëve.

Nëse e gjykon se i duhet të mbledhë informacion ose të hetojë administrativisht, kthen përgjigje jo më vonë se 20 ditë nga data e marrjes së tyre.

Nëse autoritetit shitës dhe/ose ankimuesit i kërkohet informacion ose dokumente të tjera, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri, pas marrjes së informacionit.

- KPP-ja, në çdo kohë, pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, mund ta lejojë autoritetin shitës, me anë të një urdhri të ndërmjetëm deri në një vendim përfundimtar, për këtë rast, të vazhdojë procedurën e ankandit, në rastet kur:

i) disponon informacion se mund të ndodhë që ankimuesi të mos ketë sukses me ankesën;

ii) pezullimi do të dëmtonte tërthorazi interesin publik, autoritetin shitës ose ofertuesit.

Kjo masë mund të revokohet në çdo kohë.

- Përpara lidhjes së kontratës, KPP-ja, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit shitës ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

i) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

ii) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit shitës, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha specifikimet teknike ose lloje të tjera specifikimesh, që nuk pajtohen me këtë ligj;

iii) të udhëzojë autoritetin shitës të korrigjojë shkeljet dhe të vazhdojë me procedurën e ankandit të kontratës, pas korrigjimit të tyre;

iv) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

- Pas lidhjes së kontratës, kur KPP-ja gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit shitës është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e LAP-së, ka të drejtë:

i) të bëjë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

ii) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së LAP-së;

iii) të vendosë masa ndaj personave përgjegjës, sipas parashikimeve të nenit 43/4, të LAP-së.

- Pas marrjes së vendimit, KPP-ja duhet të sigurojë se:

- autoriteti shitës do të ndërmarrë veprimet e nevojshme.

21. Komisioni i shitjes përveç përcaktimeve të bëra më sipër do të zbatojë edhe aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me shitjen me ankand të mallrave.

22. Autoriteti shitës i paraqet informacion Ministrit, për çdo shitje të produktit hidrokarbur të realizuar nëpërmjet procedurës së mësipërme.

Shoqëria "Albpetrol" sh.a. Patos njofton autoritetin doganor dhe tatimor, si dhe IQT e AKBN, për çdo shitje të produktit brenda vendit apo për eksport, si dhe kërkon konfirmimin nga ky institucion për sasinë e eksportuar.

23. Të gjitha operacionet e shitjes së produkteve hidrokarbure do të dokumentohen me saktësi dhe do të bëhen në përputhje me kërkesat dhe praktikat e përcaktuara nga Ministria e Financave.

24. Deri më datë 10 të çdo muaji, kryetari i autoritetit shitës paraqet në METE një raport analitik argumentues mbi efektin fitimprurës të transaksioneve financiare të kryera në muajin paraardhës në zbatim të këtij urdhri.

25. Të gjitha ditët e përcaktuara në këtë urdhër janë ditë kalendarike.

26. Shkeljet e procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë urdhër, kur nuk përbëjnë vepër penale të vlerësohen si shkelje e rëndë e disiplinës në punë.

27. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare të METE dhe të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos.

28. Urdhrrat nr. 515, datë 5.7.2010 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure” dhe nr. 581, datë 19.8.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 515, datë 5.7.2010 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shfuqizohen.

29. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, si dhe njësia që mbulon aktivitetin hidrokarbur në METE.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

KONTRATË SHITBLERJE

Nr _____, datë ___ / ___ / 2012

Objekti i kontratës

Shitje e produktit hidrokarbur (naftës bruto)

Kjo kontratë është e lidhur më datë ___ / ___ / 2012 midis

Autoritetit shitës “Albpetrol” sh.a. me NIPT J82916500U dhe adresë: lagjja “29 Marsi” Patos, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. _____, që këtu e më poshtë do të quhet “Shitësi”.

Dhe Kontraktuesit, shoqërisë “_____” me NIPT _____ dhe adresë _____ përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. _____, që këtu e më poshtë do të quhet “blerësi”.

Palët bien dakord të lidhin këtë kontratë shitblerje si më poshtë:

Secila palë siguron palën tjetër se ajo ka të drejtën, fuqi të plotë juridike dhe autoriteti, të hyjë në këtë kontratë shitblerjeje dhe se kjo kontratë shitblerje përbën një dokument legal dhe të vlefshëm.

Prandaj sot më datën e nënshkrimit të kontratës, autoriteti shitës dhe kontraktuesi bien dakord të lidhen ligjërisht njëri me tjetrin dhe të përmbushin kërkesat, detyrimet dhe përgjegjësitë respektive në lidhje me këtë kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Akti normativ i Këshillit të Ministrave nr.2 datë 16.6.2010 “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, urdhri nr. 83 datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”; nenet 541-545 dhe 705-756 të Kodit Civil.

Përkufizime

“Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar, e lidhur midis autoritetit shitës dhe ofertuesit, që përbëhet nga dokumentet e ankandit, duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet autoritetit shitës sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.

“Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtarë tregtarë që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtarë që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot dhe rrisqet e lidhura me transferimin e mallrave nga autoriteti shitës tek ofertuesi fitues.



“Livrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e mallrave në vendin e shpërndarjes, siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

“Autoriteti shitës” do të thotë autoriteti shitës, që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate, shet mallrat. Ky term, kudo që përdoret, ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.

“Ofertues fitues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate, bien mallrat.

“Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.

“Shërbimet në lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të mallrave, si: transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e mallrave.

“Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha mallrat dhe shërbimet në lidhje me to që autoriteti shitës do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“Standarde teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave, për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 1

Objekti i kontratës

1.1 Objekt i kësaj kontrate është “Shitje e produktit hidrokarbur (naftës bruto)” sasia _____ ton.

1.2 Autoriteti shitës është i detyruar t’i shesë shoqërisë “_____” sh.a. mallin e përcaktuar në këtë kontratë, në cilësinë dhe sasinë e kërkuar, të ndarë në _____ parti, si më poshtë:

- Partia e parë _____ ton
- Partia e dytë _____ ton
- Partia e tretë _____ ton.

1.3 Nisur nga procedural teknike të matjeve dhe magazinimit të naftës bruto, do të lejohen ndryshime në sasinë totale të kontratës deri në masën ($\pm 2\%$).

Neni 2

Pikat e livrimit dhe çmimi i shitjes

2.1 Shitja e naftës bruto do të bëhet në një nga stacionet e QTNG Patos, si më poshtë:

- Stacioni Zharrëz,
- Stacioni Kuçovë,
- Stacioni Sheqishte

- Stacioni Gorrisht, në depot e shitjes së naftës bruto në administrim dhe përdorim të shitësit në QTNG Patos, i autorizuar për shitje nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos.

2.2 Çmimi i naftës bruto pa TVSH, është fiksuar sipas **urdhrit nr. _____ datë _____** “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure” dhe do të jetë _____ \$/bbl.

2.3 Brent është treguesi i publikuar në Platts European Marketscan, në datën e kryerjes së pagesës.

2.4 Për konvertimin e çmimit nga \$/bbl në \$/ton, do të përdoret koeficienti i konvertimit i përlllogaritur sipas densitetit të naftës së shitur.

$$Y = 1/(0.158984 * \text{densiteti } 15.5 \text{ } ^\circ\text{C})$$

2.5 Llogaritja e naftës bruto që do të shitet dhe plotësimi i faturës teknike do të bëhet me të dhënat, si më poshtë:

- Vëllimi i naftës bruto neto në m³ në temperaturën mesatare të depos;
- Pesha e naftës bruto neto në ton.

2.6 Fatura teknike plotësohet me emrat e anëtarëve të të dyja komisioneve dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e komisioneve.

2.7 Të dhënat që do të dokumentohen nga të dyja komisionet gjatë shitjes-blerjes:

- Numri i depos që shitet;
- Lartësia e kolonës së naftës bruto në cm;
- Temperatura mesatare e depos, °C;
- Data dhe ora e marrjes së kampionit mesatar të naftës (1+3+1);
- Rezultatet e analizave të kampionit mesatar të naftës:
 - Përmbajtja e ujit (% në peshë);
 - Përmbajtja e mbeturinave mekanike (% në peshë);
 - Densiteti i naftës në temperaturën e laboratorit dhe sipas standartit SSH 33, në 15.5 °C.

2.8 Fatura financiare në momentin e shitjes do të plotësohet mbi bazën e të dhënave të faturës teknike dhe çmimit të naftës, të përlogaritur sipas pikave 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij neni.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e shitësit

3.1 Shitësi merr përsipër të furnizojë blerësin me naftë bruto të përcaktuar në nenin 1, pikat 1.1 dhe 1.3.

3.2 Shitësi përpilon faturën financiare dhe ia paraqet blerësit sipas pikës 2.5 në nenin 2 të kësaj kontrate.

3.3 Shitësi do të respektojë kërkesat teknologjike të blerësit për: ³¹

- Përmbajtja e ujit në naftë, jo më shumë se 4.6%;
- Densiteti i naftës bruto, jo më i madh se 995 kg/m³;
- Përmbajtja e mbeturinave mekanike, jo më shumë se 0.1%.

3.4 Shitja do të bëhet në prani të komisionit të shitësit dhe të blerësit.

3.5 Si rregull, shitja do të bëhet brenda ditës jo më parë se ora 7:30 dhe jo më vonë se ora 19:00. Për raste të veçanta, kur gjatë ditës, ndodh kohë e keqe dhe me shkarkesa atmosferike, me mirëkuptim të dyja palëve ora e shitjes përcaktohet prej tyre.

3.6 Shitësi do të përfaqësohet në shitjen e naftës bruto nga QTNG Patos, nëpërmjet përgjegjësit të qendrës së shpërndarjes së naftës bruto, dhe/ose personat e autorizuar nga shoqëria “Albpetrol” sh.a.

3.7 Shitësi është i detyruar të vërë në dispozicion të blerësit sasi të dhe stacionet përkatëse ku do të bëhet shitja e naftës jo më vonë se dy ditë nga data e firmosjes së kësaj kontrate dhe të përcaktojë radhën e dorëzimit të rezervuarëve.

Neni 4

Mënyra e pagesës dhe dokumentet

4.1 Veprimet financiare, objekt i kësaj kontrate, do të bëhen nga kontraktuesi në favor të autoritetit shitës “Albpetrol sh.a Patos” në Bankën Raiffeisen, dega Fier me nr. llogarie 0300000767 dhe/ose në llogarinë e “Albpetrol” sh.a. me nr. 0200-301128-101 pranë Tirana Bank, filiali Fier.

4.2 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e blerësit në llogarinë e autoritetit shitës “Albpetrol” sh.a.

4.3 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t’i paguhet autoritetit shitës si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

4.4 Autoriteti shitës duhet të shoqërojë mallin me dokumentet e mëposhtme:



- Originalin e faturës tatimore të shitjes;
- Originalin e faturës teknike të përpiluar dhe firmosur nga komisionet e shitësit dhe blerësit.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit

5.1 Të paguajë detyrimin për blerjen e naftës bruto për sasi të përkatëse të specifikuar në nenin 1 pika 1.2 të kësaj kontrate me parapagim të specifikuar, si më poshtë:

5.1.1 Partia e parë do të likujdohet jo më vonë se 10 ditë nga dita e firmosjes së kontratës.

5.1.2 Partia e dytë do të likujdohet menjëherë pas livrimit të partisë së parë, por jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

5.1.3 Partia e tretë do të likujdohet jo më vonë se data ___ / ___ / 2012.

5.2 Livrimi i partive të specifikuar në nenin 1 pika 1.2 do të fillojë pas konfirmimit të pagesës së detyrimit për sasi të përkatëse, të specifikuar në pikën 5.1 (5.1.1; 5.1.2; dhe 5.1.3.) të këtij neni.

5.3 Për moslikuidimin e detyrimeve sipas përcaktimeve të pikës 5.1 të këtij neni, shitësit i lind e drejta për të ndërprerë kontratën dhe të konfiskojë sigurimin e kontratës.

5.4 Blerësi do të përfaqësohet në shitjen e naftës bruto nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë.

5.5 Blerësi është i detyruar të njoftojë shitësin, para fillimit të shitjes, për komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim; personat e autorizuar për firmosjen e faturave përkatëse dhe listën e mjeteve të transportit me certifikatat përkatëse.

5.6 Blerësi është i detyruar që pas marrjes së njoftimit sipas pikës 3.8 të nenit 3 të kësaj kontrate, të njoftojë me shkrim QTNG Patos për grafikun përkatës të tërheqjes së mallit, me sasi të stacionet dhe afatet përkatëse.

5.7 Blerësi është i detyruar të garantojë tërheqjen e sasisë së naftës objekt i kësaj kontrate nga "Albpetrol" sh.a. sipas afatit të rënë dakord, por jo më vonë se 60 ditë nga data e kryerjes së pagesës.

5.8 Blerësi në rastet kur nuk ekzekuton detyrimet siç janë parashikuar në këtë kontratë është i detyruar t'i paguajë shitësit në formën e kushtit penal 10% të shumës së paekzekutuar të detyrimit, si dhe pjesën e dëmit të shkaktuar që kalon kushtin penal.

Neni 6

Procedurat e marrjes së kampioneve dhe analizës së mallit

6.1 Mbasi rezervuari pritës i naftës bruto të jetë mbushur sipas kushteve teknike, mbyllet saraqineska e hyrjes dhe e daljes së rezervuarit.

6.2 Në momentin që do të dorëzohet rezervuari, do të kryhet matja fizike e lartësisë së lëngut në rezervuar. Më pas kryhet konvertimi në m³ sipas tabelave përkatëse të kalibrimit të çdo rezervuari.

6.3 Në praninë e përfaqësuesve të autorizuar nga shitësi dhe blerësi organizohet marrja e kampionit të naftës bruto në rezervuarin e naftës të përgatitur për shitje sipas SSH 47. Kampioni do të përgatitet nga përzjerja e sasive të (1-3-1) të naftës bruto të marrë në tre lartësi të ndryshme të rezervuarit, e konkretisht:

- Kampioni i parë, 20 cm nën nivelin e sipërm të lëngut në rezervuar (një njësi);

- Kampioni i dytë, në mesin e nivelit të lëngut në rezervuar që është midis sipërfaqes së lëngut dhe aksit të saraqineskës të thithjes nga rezervuari (tre njësi);

- Kampioni i tretë merret në aksin e saraqineskës të thithjes së rezervuarit (një njësi).

6.4 Kampionimi dhe analizat do të kryhen nga personel i kualifikuar për matje të tilla dhe të autorizuar nga shitësi gjithmonë në prani të të dyja palëve.

6.5 Para marrjes së kampioneve të naftës në prani të të dyja komisioneve kontrollon rezervuari për përmbajtjen e ujit të lirë në nivelin e daljes nga rezervuari.

6.6 Kampioni mesatar për analizë do të përgatitet nga përzjerja e tre monstrave të marra në të trija lartësitë e rezervuarit. Nga kjo përzjerje merret monstra për kryerjen e analizës për përcaktimin e përmbajtjes së ujit sipas SSH 35 dhe të mbetjeve mekanike në naftën bruto sipas SSH 43.

6.7 Analizat do të kryhen në laboratorin e stacionit përkatës, në prani të të dyja komisioneve.

6.8 Analiza e kampionit do të fillohet me matjen e temperaturave mesatare të rezervuarit dhe të kampionit në cilindër.

6.9 Densiteti i kampionit do të përcaktohet sipas metodës SSH 33, duke përdorur një aerometër të përshtatshëm dhe të kontrolluar. Temperatura dhe densitetet e matura dhe të korrektuara do të regjistrohen në “Raportin e analizave të naftës bruto” të përgatitur për kampionim.

6.10 Përmbajtja e ujit në kampionin mesatar do të bëhet duke përdorur metodën SSH 35 (Metoda Dean Stark).

6.11 Përmbajtja e lëndëve mekanike do të bëhet duke përdorur metodën SSH 43 (centrifugë).

6.12 Mbas analizës do të përgatitet “Raport i analizave të naftës brut” (raport analizë) në të cilin do të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Data dhe ora kur është bërë kampionimi;
- Numri i rezervuarit nga i cili është bërë kampionimi;
- Densiteti i matur dhe temperatura gjatë matjes së densitetit;
- Përmbajtja e ujit në përqindje në volum ose peshë;
- Përmbajtjen e lëndës mekanike në përqindje në volum ose në peshë;
- Emrat e plotë të përfaqësuesve të “Albpetrol” sh.a. dhe _____ sh.a.;
- Firmat e të dy përfaqësuesve të “Albpetrol” sh.a. dhe _____ sh.a.

6.13 Mbi bazën e “Raport analizave të naftës bruto” do të hartohet fatura teknike për sasinë neto në (ton) të naftës bruto, si dhe hartimi i faturës financiare për sasinë e naftës që do të shitet.

6.14 Pas përpilimit të faturës teknike dhe asaj tatimore shitjeje për rezervuarin përkatës, pala blerëse merr në dorëzim rezervuarin dhe detyrohet ta kthejë atë të boshatisur brenda 10 ditëve nga data e plotësimit të kësaj fature. Për çdo ditë tej afatit 10-ditor të dorëzimit të rezervuarit, blerësi është i detyruar të paguajë ___ lekë/ditë.

6.15 Në rast se blerësi nuk bie dakord me analizat e kryera në laboratorët përkatës të shitësit, atëherë ai mund të kryejë me shpenzimet e veta, por në prani të përfaqësuesve të autorizuar të shitësit, analiza në laborator të licencuar të zgjedhur me mirëkuptim midis të dyja palëve.

Neni 7

Forca madhore

7.1 Blerësi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuajuara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si rezultat i ndodhjes së forcës madhore.

7.2 Për qëllimet e këtij neni, “Forcë madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e autoritetit kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

7.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e forcës madhore, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë autoritetin shitës. Me përjashtim kur autoriteti shitës jep direktiva të ndryshme, kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga forca madhore



Neni 8

Negociatat dhe amendamentet

8.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktuesit.

8.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktuesit dhe autoritetit shitës.

8.3. Çdo heqje dorë nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 9

Ndërprerja për mosplotësim

9.1 Autoriteti shitës mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse: blerësi dështon në tërheqjen e mallit brenda periudhës së specifikuar në kontratë.

9.2 Autoriteti shitës duhet t'i japë kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim.

9.3 Autoriteti shitës mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

9.4 Autoriteti shitës mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Autoriteti shitës dhe blerësi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

10.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë (secila palë ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Shkallës Parë të Rrethit Gjyqësor Fier për zgjidhjen e konfliktit).

Neni 11

Kushte të tjera

11.1 Të gjitha afatet e cituara në këtë kontratë janë kalendarike.

11.2 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

11.3 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet zyrtarisht te palët.

11.4 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

11.5 Çmimet e caktuara në këtë kontratë janë fikse dhe nuk ndryshojnë me bisedime gjatë kohës së ekzekutimit të kësaj kontrate.

11.6 Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e firmosjes së saj nga të dyja palët.

11.7 Kontrata hartohet në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë. Kontrata e mësipërme, pasi u lexua, u kuptua, firmoset me vullnetin e lirë të palëve.

Blerësi
Përfaqësuesi ligjor

Shitësi "Albpetrol" sh.a. Patos
Përfaqësuesi ligjor

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.3.2012
Doli nga shtypi më 19.3.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 46 lekë